

VENDIM
Nr. 713, datë 11.11.2022

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 273, DATË 6.4.2011,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE,
QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR ‘UNAZA LINDORE
SHKODËR’”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 273, datë 6.4.2011, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në pikën 3 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Sipërfaqja truall prej “... 24 875.6 (njëzet e katër mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e pesë pikë gjashtë) m² ...” zëvendësohet me “... 25 014.1 (njëzet e pesë mijë e katërmëdhjetë pikë një) m² ...”.

b) Vlera e përgjithshme e shpronësimit “... prej 243 642 950 (dyqind e dyzet e tre milionë e gjashtëqind e dyzet e dy mijë e nëntëqind e pesëdhjetë) lekësh ...” zëvendësohet me “...prej 244 821 724 (dyqind e dyzet e katër milionë e tetëqind e njëzet e një mijë e shtatëqind e njëzet e katër) lekësh ...”.

2. Pika 5 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 244 821 724 (dyqind e dyzet e katër milionë e tetëqind e njëzet e një mijë e shtatëqind e njëzet e katër) lekësh, përballohet, si më poshtë vijon:

a) Vlera 243 642 950 (dyqind e dyzet e tre milionë e gjashtëqind e dyzet e dy mijë e nëntëqind e pesëdhjetë) lekë përballohet nga llogaria e veçantë e Ministrisë së Financave, pranë Bankës së Shqipërisë, “Fondi i shpronësimeve”;

b) Vlera 1 178 774 (një milion e njëqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e katër) lekë përballohet nga buxheti i Autoritetit Rrugor Shqiptar.”.

3. Tabelës bashkëlidhur vendimit në fuqi i shtohet tabela, bashkëlidhur këtij vendimi.

II. Shpenzimet procedurale, në vlerën prej 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekësh, përballohen nga buxheti i Autoritetit Rrugor Shqiptar.

III. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në “Fletoren zyrtare” dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

IV. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin, Autoriteti Rrugor Shqiptar dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Shkodër, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

LISTA EMËRORE PËRFUNDIMTARE E PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE QË PREKEN NGA DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 273, DATË 6.4.2011, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR ‘UNAZA LINDORE SHKODËR’”

Nr.	Pronari			ZK	Nr. i pasurisë	Sipërfaqe totale e pronës. m ²	Të dhënat e pasurisë				VLERA TOTALE (Lek)	Adresa e pronarit	Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri				Sip. m ²	Çmimi m ²	Vlera në lek	Lloji i pasurisë			
1	Nike	Lulash	Lufaj	8593	12/443	274	48.5	8511	412,784	Truall	412,784	Bashkia Shkodër	Konfirmuar nga ASHK-ja
2	Gjyzipina	Zef	Toma	8593	12/461	300	90	8511	765,990	Truall	765,990	Bashkia Shkodër	Konfirmuar nga ASHK-ja
	Luigj	Mati											
	TOTALI						138.5		1,178,774		1,178,774		